



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQËNIES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
SHKODËR
NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR LEZHË

Lënda: Kërkesë për plotesim ,(vënd vakand) Operator/e

Në mbështetje dhe zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të VKM nr. 419, datë 04.07.2018 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”, “Rregullores së Brendshme për Mënyrën e Funksionimit dhe Organizimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor” miratuar me Urdhër nr. 18, datë 17.01.2019 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ne zbatim të Udhëzimit nr. 206, datë 09.04.2024

“Për procedurat e punësimit, emërimit, pezullimit, lirimit dhe të disiplinës të punonjësve të administratës në ,NJVKSH dhe Drejtoritë e shërbimit Spitalor në varësi të OSHKSH-së”

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Lezhë njofton shpalljen e 1 (një) vendi të lirë në pozicionin si vijon:

NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR LEZHË
SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Pozicioni: Operator/e.

Arsimi : Te ketë mbaruar arsimin e mesëm

Përvoja: Preferohet me përvojë në pozicione të ngjashme.

Njohuri dhe aftësi: Njohuri shumë të mira të paketës Microsoft Office për hedhjen e sakte të të dhënave që vijnë ne sektor dhe përpunimi i tyre sipas formulareve përkatës. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe pune në grup e aftë të përmbushë me korrektësi dhe në kohë detyrat e ngarkuara.

Aplikantet që duan të konkurojnë për këtë vend pune duhet të paraqesin dokumentat si me poshte :

1. Kerkese me shkrim.
2. Curriculum vitae . (CV)
3. Diplomë e shkollës së mesme (*fotokopje e noterizuar*).
4. Dokumentin e identitetit .
5. Dëshmi kompjuteri.
6. Raport mjeksor.

7. Vertetim nga Gjykata e Prokoria e rrethit Lezhë.
8. Dëshmi penalitetit
9. Librezë punë ose fotokopje e plote.
10. Vlerësim pune nga punëdhësi i mëparshëm (*nese ka*).

Aplikimet pranohen nga data 18.12.2025 deri më 26.12.2025, përfshirë të dyja këto data.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së burimeve njerëzore, që luan rolin e sekretariatit teknik, pranë insitucionit që ka kërkuar publikim e vendit vakant, sipas një formati i cili parashkruan të gjithë dokumentacionin në dosje të aplikantit dhe firmoset nga specialisti që merr në dorëzim kërkesën dhe aplikanti.

Proçesi i rekrutimit përmban tre faza vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit:

1. Vlerësimi i dosjes (deri në 30 pikë)
2. Vlerësimi me shkrim (deri në 40 pikë)
3. Vlerësimi i intervistës së strukturuar (deri në 30 pikë)

Kandidati/ët do të konsiderohen të kualifikuar në rast se kalojnë kufirin minimal të pikëve:

a) për pozicionin specialist: 50 e më shumë pikë;

Në përfundim të tre fazave, shumatorja e pikëve (100 pikë) përcakton listën e fituesve sipas renditjes.

Pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Vlerësimit shqyrton paraprakisht dosjet e kandidatëve duke kaluar për fazat e mëtejshme kandidatët të cilat përmbushin kriteret e përcaktuara.

Testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë synojnë vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive të lidhura me pozicionin për të cilin aplikon kandidati.

Fushat e njohurive dhe aftësive mbi të cilat do të zhvillohet vlerësimi:

Ligjin Nr. 10107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligjin Nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”, i ndryshuar;

Ligjin Nr. 7961, datë 12.05.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Kandidatët do të njoftohen në formën e dakortësuar me e-mail personal dhe/ose me sms në numrin e telefonit të vendosur në CV.

Çdo kandidat ka të drejtën për ankimim të procedurës jo më vonë se 48 orë nga marrja e njoftimit me e-mail, në adresën elektronike zyrtare nëpërmejt së cilës janë bërë me dije për vlerësimin apo moskualifikimin dhe/ose me shkresë drejtuar Komisionit të Vlerësimit

SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

ZYRA E BURIMEVE NJERËZOR